

VENDIM
Nr. 100, datë 20.2.2012

**PËR DHËNIE NDËRTESE PËR SELINË QENDRORE TË PARTISË PËR DREJTËSI,
INTEGRIM DHE UNITET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 e 22/1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kati i parë i ndërtesës, dhënë në përdorim për selinë qendrore të ish-Partisë Demokratë, Tiranë, i ndodhur në rrugën “Myslym Shyri”, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi, të jepet si ndërtesë për selinë qendrore të Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

2. Vendimi nr. 4, datë 5.1.2002 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie ndërtese për selinë qendrore të Partisë Demokratë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha